

Gjuha

Ju keni ardhur me shtëpi në Basel-Landschaft dhe ende nuk e flisni gjuhën gjermane? Atëherë bëni mirë të mësoni sa më parë gjermanisht. Kur flisni gjuhën, ju njiheni më mirë me vendin dhe njerëzit. Dhe gjeni më lehtë punë.

Gjuha letrare gjermane / gjermanishtja zvicerane

Zvicra ka katër gjuhë vendore: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retroromanisht. Në kantonin Basel-Landschaft gjuha gjermane është gjuha zyrtare. Ka gjuhën letrare gjermane (Hochdeutsch) dhe gjermanishten zvicerane (Schweizerdeutsch).

- Gjermanishtja standarde (Standarddeutsch)
Njerëzit në pjesën gjermane të Zvicrës shkruajnë në gjermanishten standarde. Dhe ata flasin gjermanishten standarde në shkollë dhe pjesërisht ë radio dhe në televizor.
- Gjermanishtja zvicerane (Schweizerdeutsch)
Gjermanishtja zvicerane është një dialekt i gjuhës gjermane. Njerëzit flasin në jetën e përditshme më shumë gjermanishten zvicerane. Ndoshta gjermanishten zvicerane e keni të vështirë të kuptoni, edhe kur tashme flisni mirë gjermanisht. Ju nuk kuptoni diçka? Atëherë mund të lutni njerëzit me gjithë dëshirë, që ata të flasin gjermanishten standarde me ju. Nuk është nevoja që ju vetë të flisni gjermanishten zvicerane. Por është e rëndësishme që ta kuptoni pas një farë kohe.

Gjermanishtja dhe fëmijët

Fëmija juaj flet një gjuhë tjetër në vend të gjermanishtes? Atëherë ai duhet të njihet sa më parë me fëmijët, që flasin gjermanisht. Kështu fëmija juaj mëson më shpejt. Ai mund të shkojë për shembull në një grup për lojë. Ka edhe oferta speciale për prindër dhe fëmijë.

Edhe ju mund të përkrahni fëmijën tuaj në zhvillimin e tij gjuhësor. Flisni shumë me fëmijën tuaj, dëgjoni, kur fëmija juaj flet, dhe tregoni histori. Flisni në atë gjuhë, të cilën zotoni më mirë dhe që e preferoni.

Përkthimet me shkrim / Përkthimet me gojë

Ju sapo keni ardhur me shtëpi në Basel-Landschaft dhe ende nuk flisni mirë gjermanisht? Atëherë nganjëherë ju duhet një person, që përkthen për ju. Ndoshta mund të pyesni të afërmit ose persona të njohur.

Mirëpo ka situata, në të cilat janë të vështira ose shumë personale. Për shembull një takim në spital ose në një zyrë. Atëherë ju dëshironi më mirë një përkthyes ndërkulturore ose një përkthyes ndërkulturore. Këta janë specialistë posaçërisht për njerëz, që vijnë nga një kulturë tjetër. Specialistet njohin kulturën tuaj dhe mund të përkthejnë në këtë mënyrë, që ju kuptoni gjithçka.

Ju merrni letra nga zyra shtetërore dhe nuk e kuptoni? Ose duhet të plotësoni një formular ose të shkruani një letër? Këtu gjeni ndihmë:

- Shërbimi i përkthimit nga Ausländerdienst ald
- Schreibstube Liestal

Nivelet e gjuhës në emigracion dhe të drejtën civile

Ndoshta doni të aplikoni për leje qëndrimi (B) ose leje vendbanimi (C). Ose dëshironi marrjen e nënshtetësisë. Gjermanishtja nuk është gjuha juaj e parë? Atëherë ju duhet një vërtetim, që flisni mirë gjermanisht.

Këtu merrni informacione, se çfarë ju duhet për aplikimin:

- Zyra e migracionit (Amt für Migration und Bürgerrecht)

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha